

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br. 23733/25
Nr. i fq. / Br. st. - 3 -
Data: / Datum 28-05-2025

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 83/25 28/05/2025

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 23 prill 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:55.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Zdravko Zdravkoviç (kryesues), Kushtrim Hyseni, Zojë Hajrizi, Behar Duraku, Gresa Muli, Zana Krasniç Saraçi, Berat Maloku, Aziz Emini dhe Adem Hoti, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësues të KFOR-it slloven, OSBE-së, Aktere Dërvari - përkthyes, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Zdravko Zdravkoviç, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Diskutim lidhur me vizitën e anëtarëve të Komitetit te familjet në nevojë;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Diskutim lidhur me vizitën e anëtarëve të Komitetit te familjet në nevojë.

Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit – sa i përket kësaj teme, kemi biseduar edhe në mbledhjen e kaluar se nëse hasim në ndonjë familje që është në gjendje të vështirë, ta gjejmë mundësinë që t'i ndihmojmë aq sa mundemi.

Aziz Emini, anëtar i komitetit – tha se në lagjen rome ka shumë familje që janë në gjendje të vështirë, por i kemi veçuar 8 familje. E kam përmendur disa herë një familje që janë të sëmurë psikikisht, të cilën edhe e kemi vizituar vitin e kaluar. Po ashtu, një familje tjetër është një çift që jetojnë vetëm. Ata e kanë një vajzë, e cila është martuar. U duhet

ndihmë, sepse burri ka pasur një sulm vitin e kaluar. Janë edhe gjashtë familje tjera që kanë nevojë për ndihmë. Unë me Zdravkon e Ademin jemi afër me banim dhe mundemi bashkërisht t'i vizitojmë këto familje dhe anëtarët tjerë mos të maltreohen që të vijnë.

Adem Hoti, anëtar i komitetit - deklaroi se janë dy familje në fshatin Stanoc që kanë nevojë për ndihmë. Andaj, kushdo që dëshiron të vij mund të shkojmë që t'i vizitojmë.

Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit – qëllimi ynë është që t'i vizitojmë ato familje dhe ta gjejmë mundësinë për t'i ndihmuar. Pasi t'i identifikojmë familjet, ta shohim se për çfarë ndihme kanë nevojë: ushqim, veshmbathje, gjëra higjienike, nxjerrjen e ndonjë dokumenti. E kemi grupin në viber dhe mund të kontaktojmë për mundësinë e vizitës së këtyre familjeve.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – sa i përket një familje në Prelluzhë që janë të sëmurë psikikisht, kam qenë vitin e kaluar në vizitë dhe u kemi dërguar ndihma. Mendoj që ajo familje më shumë ka nevojë për mjek, sesa për gjëra tjera. Pasi që ajo familje është nga komuniteti serb, kisha kërkuar nga Zdravko që t'ia gjejnë një mjek nga komuniteti serb. Kjo për shkak se kur isha në vizitë, ajo familje nuk pranonte asnjë ndihmë nga komuniteti shqiptar. Andaj, gjejeni një psikolog të mirë që e flet gjuhën serbe dhe ta vizitojnë këtë familje. Qëllimi është që të bëhet zgjidhje. Kurse, sa u përket ndihmave, unë jam i gatshëm që t'ju dërgojmë ndihma ushqimore.

Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit – mendoj që atyre familjeve mund t'u ndihmohet me gjëra ushqimore, por jo siç ka qenë më herët. Sa i përket ndihmës mjekësore, nuk e di se a do ta pranojnë. Kjo familje është e mbrojtur në aspektin social nga Serbia. Duhet ta shohim mundësinë se sa mund t'i bindim për kontrolle mjekësore.

Aziz Emini, anëtar i komitetit - familjen që e përmenda unë, shërbimin mjekësor e kanë të mirë, sepse ju ofrohet ndihma mjekësore. Ka pasur raste që vet kanë shkuar te mjeku. Ata janë të qetë kur e marrin terapinë. Kur kemi qenë me Beratin në vizitë vitin e kaluar, ata kanë qenë shumë agresiv dhe nuk kanë dashur ndihmë. Në atë familje jeton nëna me tri vajza dhe djali.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – institucionet që janë përgjegjëse duhet të ftohen që ta vizitojnë këtë familje. Kjo familje e merr një ndihmë nga Serbia. Një fjalë më pengoi kur më thanë se nëse marrim ndihma nga shqiptarët, ua ndalim ndihmat nga Serbia. Andaj, kushtoni rëndësi kësaj familjeje, sepse kanë nevojë shumë për psikolog dhe mund të paraqesin rrezik për rrethin ku jetojnë.

Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit – komunikimi me këta njerëz është shumë i vështirë, sepse janë të sëmurë mentalisht. Jam teknik medicinal dhe e kuptoj këtë, se është shumë vështirë t'u ndihmohet njerëzve të tillë. Prandaj, personat e tillë duhet të dërgohen në institucione të posaçme për trajtim. Kjo familje nuk është e rrezikshme për rrethin ku jetojnë. I kam dëgjuar edhe unë që kanë thënë se nëse pranojnë ndihma tjera, na i ndalin ndihmat. Pa marrë parasysh se nga cili komunitet marrin ndihma, e thonë atë, sepse janë të sëmurë mental dhe mendojnë në atë mënyrë dhe nuk bën t'i fajësojnë.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – një fjalë popullore thotë: “Kur do bën zgjidhje, kur nuk do gjen arsye”. Prandaj, ndiej keqardhje për këtë familje dhe të gjendet mënyra për t'ju ndihmuar.

Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit – tha se do të mundohemi ta gjejmë mundësinë që t'ju ndihmojmë këtyre familjeve.

3. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës

pen

